



Prishtinë, 16 mars 2017
Kodi i ZRRE-së: V_900_2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 13 par 1 dhe nenin 14 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Caqet e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë;
- Nenin 4 paragrafi 9, 10 dhe 11 të Rregullës për Skemën Mbështetëse;
- Vendimin nr. V-810-2016 dt. 19 maj 2016 për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë;
- Aplikacionin/Kërkesën për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga era, "Wind Park-Koznica", ZK Koznicë, me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW, në Komunën e Novobërdës, të datës 05.12.2016 të shoqërisë "PRIHTINA - ENERGY" SH.P.K., me adresë: Sheshi "Nënë Terezë" nr.46/5, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, dhe
- Aplikacionin për Pranin në Skemën Mbështetëse;

në seancën e mbajtur me datë 16 mars 2017 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I. I lëshohet **AUTORIZIMI PRELIMINAR** shoqërisë "PRISHTINA - ENERGY" SH.P.K., për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga era, "Wind Park-Koznica", ZK Koznicë, me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW, në Komunën e Novobërdës, Republika e Kosovës.
- II. Aplikuesit "PRISHTINA - ENERGY" SH.P.K., do t'i lëshohet **AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga era "Wind Park-Koznica", pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimentit të ri gjenerues para se t'i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.

- IV. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar përcakton se, procesi për pranim në skemën mbështetëse do të ndalohet derisa, të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik e Republikës së Kosovës.
- V. Me Vendimin mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar përcaktohet se aplikacioni i shoqërisë "PRISHTINA - ENERGY" SH.P.K., konsiderohet si aplikacion "në pritje", për pranim në skemën mbështetëse.
- VI. Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar lëshohet për periudhë një (1) vjeçare, brenda së cilës periudhë aplikuesi obligohet që ti plotësoi kërkesat sipas pikës II. të dispozitivit të këtij Vendimi, dhe me shkrim të kërkoj lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimenteve të reja gjeneruese.
- VII. Afati i Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar i përcaktuar me dispozitivin nën pikën VI. i këtij vendimi, do të fillojnë të rrjedh, jo nga data e lëshimit të këtij vendimi, por nga data e njoftimit me shkrim nga ZRRE për përfshirje në skemën mbështetëse.

Arsyetim

- o ZRRE me datë 05.12.2016 nga shoqëria "PRISHTINA - ENERGY" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapacitetit të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga era "Wind Park-Koznica", ZK Koznicë, me kapacitet të instaluar prej 34.5 MW, në Komunën e Novobërdës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE me datë 05.12.2016 nga shoqëria "PRISHTINA - ENERGY" SH.P.K., ka pranuar aplikacioni për pranim në skemën mbështetëse.
- o ZRRE- me datë 18.01.2017 i ka lëshuar njoftimit shoqërisë "PRISHTINA - ENERGY" SH.P.K., ku ka theksuar se: ZRRE ka pranuar/evidentuar disa aplikacione për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nge era, dhe aplikacioni juaj i tejkalon caqet e BRE-ve, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 të nxjerr nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik. Po ashtu ka njoftuar se me Rregullën për Pranim në Skemën Mbështetëse tarifa nxitëse "Feed in" do ju garantohet vetëm aplikuesve që kanë marr Autorizim Preliminar apo Final që janë brenda caqeve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013.
- o ZRRE në njoftimin përkatës ka njoftuar se: nëse aplikuese dëshiron të vazhdoj me procedurat për marrjen e Vendimit Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar apo Autorizimin Final, në vendimin përkatës do të specifikohet se procesi për pranim në skemën mbështetëse do të ndalohet derisa të lirohen caqet e disponueshme sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2013, dhe ka sqaruar se ZRRE do e njoftoj aplikuesin sipas rendit të aplikacioneve me rastin e lirit të caqeve të disponueshme.
- o ZRRE me datë 14.02.2017 nga shoqëria "PRISHTINA - ENERGY" SH.P.K., ka pranuar njoftimit për vazhdimin e shqyrtimit të aplikacionit, pasi që dëshirojnë të mbeten si aplikacion "**në pritje**" për tu pranuar në skemën mbështetëse për tërë kapaciteti instalues sipas Rregullës për Pranim në Skemën Mbështetëse.
- o ZRRE, pas vlerësimit të kërkesave dhe dëshmive relevante të bashkangjitura aplikacionit, pranimit të dëshmive plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe vlerësimit të përmbajtjes së


aplikacionit për pranim në skemën mbështetëse, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


VIII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IX. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Krenar Bujupi, u.d kryesues


Arsim Janova, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Novobërdës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së